



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno:	23.10.2024	
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-020/04	53097	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft - Rregullores për Transparencë të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Bukurije Zejnullahu - Jashari, Sektori për Marrëdhënie me Publikun, kryesues,
2. Valdete Muji, Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
3. Qendresa Jashanica-Dërmaku, Sektori për Marrëdhënie me Publikun, anëtare,
4. Burim Gashi, Drejtorati për Administratë, anëtar dhe
5. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, anëtare,

Neni 2 Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin e Draft - Rregullores për Transparencë të Komunës së Lipjanit, duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi më së largu deri më 10.11.2024.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3 Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi, anëtarët e Grupit punues dhe Zyrtarja për Konsultime me Publikun.

INr. 020/04-53097
Lipjan, më 23.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR PROJEKTIN E BUJQËSISË ME
ORGANIZATËN ISLAMIC RELIEF KOSOVA

Neni 1

Caktimi i Personave Përgjegjës

Me këtë Vendim, **Merita Zeqiri**, Zyrtare në Drejtoratin për Arsim dhe **Fatbardha Shurdhiqi** Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, **CAKTOHEN** - Persona përgjegjës për projektin e Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari dhe Organizatës "Islamic Relief Kosova" sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit Nr.1-320/01-48714 të datës 02.10.2024 e lidhur në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "Islamic Relief Kosova"

Neni 2

Detyrat Personave Përgjegjës

Personat përgjegjës janë të obliguar të bashkëpunojnë me Organizatën "Islamic Relief Kosova" për të gjitha procedurat për zbatimin e projektit të Marrëveshjes së bashkëpunimit Nr.1-320/01-48714 të datës 02.10.2024 e lidhur në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "Islamic Relief Kosova" si dhe të bashkëpunojnë për procedurat e vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve të Komunës së Lipjanit sipas thirrjes publike për aplikim Nr.12-320/01-49224 të datës 04.10.2024 për aplikacionet si në vijim: Serra me sipërfaqe 50m² dhe Motokultivator.

Neni 3

Hyrje në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Zyrtaret Përgjegjëse, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Organizata "Islamic Relief Kosova"

1Nr. 112/02-51784
Lipjan, më 14.10.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E ZYRTARES ALTERNATIVE PËR ZOTIM NË DREJTORATIN PËR ARSIM

- I. Me këtë Vendim **MERITA ZEQRIRI MAGASHI**, Zyrtare në Drejtoratin për Arsim, **CAKTOHET**, Zyrtare alternative për zotim për lëndët nga fusha e arsimit.
- II. E lartëcekura sipas nevojës së Drejtoratit Komunal për Arsim do ti kryej detyrat si Zyrtare alternative për zotim për lëndët nga fusha e arsimit.
- III Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Arsim dhe dhe zyrtarja e lartëcekur.

1Nr. 112/02-53991
Lipjan, më 29.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS**

I. Me këtë Vendim, HASAN LUMA, Zyrtar për barazi gjinore dhe mundësi të barabarta **CAKTOHET**, zyrtar përgjegjës dhe kontaktues nga Komuna e Lipjanit me Institutin e Kosovës për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë cili funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës..

II. Zyrtari i cekur në pikën I të këtij Vendimi ka detyrë dhe përgjegjësi të kontaktoj dhe bashkëpunoj me Institutin e lartëcekur përkitazi me dorëzimin e materialeve arkivore për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë për Komunën e Lipjanit

III. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Hasan Luma dhe Instituti i Kosovës për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.

1Nr. 112/02-28488
Lipjan, më 01.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft - Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, kryesues,
2. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
3. Merita Zeqiri, Drejtorati për Arsim, anëtare,
4. Liridon Duhlaku, Drejtorati për Arsim, anëtar dhe
5. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa anëtare,

Neni 2

Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin e Draft - Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit, duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi më së largu deri më 15.10.2024.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi, anëtarët e Grupit punues dhe Zyrtarja për Konsultime me Publikun.

1Nr. 020/04-48761
Lipjan, më 02.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM AD.HOC

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni i përkohshëm ad.hoc për vlerësimin e gjendjes së Stadiumit të qytetit "Sami Kelmendi" në Lipjan i dhënë paraprakisht në shfrytëzim sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463-44894 i datës 20.07.2018 , për periudë 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh për rastet e veqanta, në këtë përbërje:

1. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor-juridik Kryesues,
2. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtar,
3. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi të bëjë:

1. Verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes faktike në teren të Stadiumit "Sami Kelmendi" në Lipjan,
2. Verifikimin e zbatimit të kushteve të Kontratës Nr.1-030-40972 të datës 12.09.2018 për dhënie në shfrytëzim të Stadiumit të futbollit "Sami Kelmendi" në Lipjan
3. Komisioni është i obliguar që të hartoj Proceverbal me shkrim mbi vlerësimin e gjendjes faktike në teren të stadiumit dhe të përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e shfrytëzuesit dhe me të njëjtin ta njoftoj Kryetarin e Komunës më së largu brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit të përkohshëm Ad.Hoc 1Nr.020/04-49405 i datës 07.10.2024

1Nr.020/04-49405/2
Lipjan, më 09.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM AD.HOC

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni i përkohshëm ad.hoc për vlerësimin e gjendjes së Stadiumit të qytetit "Sami Kelmendi " në Lipjan, në këtë përbërje:

1. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor-juridike Kryesues,
2. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtar,
3. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është vlerësimi i gjendjes së stadiumit "Sami Kelmendi " në Lipjan i dhënë paraprakisht në shfrytëzim sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për periodë 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh për rastet e veqanta.

Komisioni ka për detyrë që të verifikojë gjendjen faktike në teren dhe të hartojë Procesverbal mbi vlerësimin e gjendjes faktike dhe me të njëjtin ta njoftoj Kryeatrin e Komunës më së largu brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 020/04-49405
Lipjan, më 07.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E PUNËS SË INSTITUCIONEVE EDUKATIVE – ARSIMORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Rregulloren për organizimin e punës së Institucioneve Edukative – Arsimore të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft - Rregulloren për organizimin e punës së Institucioneve Edukative – Arsimore të Komunës së Lipjanit, mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e draft Rregullores ose në email adresën rasim.hasani@rks-gov.net, më së largu me datë 18.10.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 610/01-49166
Lipjan, më 04.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **8,680.00€**, (tetë mijë e gjashtëqindë e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-48669 e datës 02.10.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 31 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shtator të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast $31 \times 280 = 8,680.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-48669
Lipjan, më 02.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës –IADK me Nr.12-/320/01-48091 të datës 26.09.2024 si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.320/01-44644 të datës 05.09.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **8.700.00 €** (tetë mijë e shtatëqind euro), për të vepruar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës –IADK me Nr.12-/320/01-48091 të datës 26.09.2024.

2.Ndarja e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-320/01-44644 të datës 05.09.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK , sipas kosos së bashkëfinancimit të përcaktuar për vitin 2024 për Komunën e Lipjanit me qëllim të implementimit të projektit të përbashkët me titull **“Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë”**, financuar nga Agjensioni Suedez në Kosovë (Sida) ku Këshilli Danez për Refugjatët (DRC) do të menaxhojë fondet nga Sida kurse Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) do të implementojë projektin i cili konform Marrëveshjes së cekur në Komunën e Lipjanit do të jetë dy vjeçar.

Neni 2

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK do ti raportoj me shkrim Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, lidhur me veprimet e ndërmarra konform dispozitave të Marrëveshjes ku përfshihet Raporti financiar lidhur me mjetet e shpenzuara dhe arsyetimi i tyre me fatura dhe dokumentacion tjetër përkatës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2024 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhironlogarinë bankare nr 2027-000021-7128-84 në TEB Bankë në emër të IADK-së.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

INr. 400/01-53839
Lipjan, më 28.10.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

